

Raporti për vitin 2023 i monitorimit të Rrjetit ALBCORS



MONITORIMI I RRJETIT AKTIV GJEODEZIK ALBCORS PËR VITIN 2023.


Stafi i sektorit përgjegjës ka përgatitur raportin e monitorimit të Rrjetit Gjeodezik Aktiv ALBCORS në bazë të monitorimit të përditshëm të përdoruesve të këtij rrjeti. Më poshtë janë trajtuar dhe paraqitur në mënyrë të detajuar të gjitha llojet dhe tipologjitë e shërbimit që kanë përdorur përdoruesit gjatë vitit 2023.

Bazuar në modulën GNS MON të platformës Geo++, jepet mundësia e analizave të ndryshme për mënyrën e qasjes së përdoruesve në lidhje me Rrjetin Aktiv ALBCORS.

Mund të themi së gjatë vitit 2023 janë realizuar **85822** lidhje me rrjetin aktiv CORS. Kjo do të thotë që tendenca e përdorimit të këtij rrjeti ka ardhur në rritje të madhe progresive, që është një indikator shumë domethënës për qëndrueshmërinë e shërbimit dhe politika e tarifimit për këtë rrjet do të fillojë të bëhet një domosdoshmëri.

Më poshtë janë paraqitur disa analiza të bëra nga specialistët e sektorit mbi mënyrën e përdorimit, tipologjinë e shërbimit dhe shpërndarjen gjeografike të përdoruesve të këtij rrjeti.

- 1- Në skemën e mëposhtme është treguar shpërndarja gjeografike e të gjitha lidhjeve të realizuara gjatë vitit 2023, pra në total kemi **85822** lidhje për të gjithë tipologjinë e lidhjeve (quality indicator).




- 2- Në tabelën e mëposhtme janë afishuar të dhënat statistikore mujore të lidhjeve të përdoruesve në të cilën duket qartë tendenca në rritje dhe lloji i lidhjes me i kërkuar (RTK FIX).

TË DHËNAT E SHËRBIMIT TË RRJETIT GJEODEZIK (ALBCORS) PËR VITIN 2023							
MUAJI	METODAT	NR. I LIDHJEVE	0 - FIX NO VALID	1 - GPS FIX	2 - DIFFERENTIAL GPS FIX	4 - RTK FIX	5 - RTK FLOAT
JANAR 2023		5393	9	411	142	3792	1039
SHKURT 2023		5942	29	471	119	4491	832
MARS 2023		6525	14	630	113	4795	973
PRILL 2023		5635	3	328	137	4436	731
MAJ 2023		6063	5	469	141	4744	704
QERSHOR 2023		6046	10	471	160	4645	760
KORRIK 2023		6908	13	2095	192	3898	710
GUSHT 2023		6201	34	1408	133	3879	747
SHTATOR 2023		5987	3	599	144	4435	806
TETOR 2023		6278	15	483	258	4610	912
NENTOR 2023		17540	18	11540	124	4747	1111
DHJETOR 2023		7304	11	747	172	5280	1094
TOTAL		85822	164	19652	1835	53752	10419
%		100%	0.19%	22.90%	2.14%	62.63%	12.14%

3- Më poshtë tregohet me i qartë numri total i lidhjeve për çdo muaj në formë grafiku.



4- Në grafikun e mëposhtëm tregohen lidhjet mujore sipas tipologjisë më të kërkuar, për çdo muaj gjatë vitit 2023.



5- Në grafikun e mëposhtem tregohet në formë përqindje (%) se si është intensiteti i tipologjisë më i kërkuar të lidhjeve.

